



• ASSEMBLY SUPPORT INITIATIVE
NEWSLETTER
GUSHT 2005, NO 18

Mesi i vitit 2005: Koha për vlerësim

*Sekretari i Përgjithshëm i KB
emëroi Ambasadorin norvegjez
Kai Aide si "Të dërguar special
për vlerësimin e përgjithshëm të
Kosovës"*



Medlin Ollbrajt iu drejtua Kuvendit të Kosovës

Editorial



Debati për demokracinë

Gjatë muajve të fundit Kuvendi i Kosovës është kritikuar për shkak të orarit të mbledhjeve, si nga qarqet brenda ashtu edhe nga disa përfaqësues të bashkësisë ndërkombëtare. Megjithatë, gjatë dy muajve të fundit Kuvendi e ka pranuar sfidën, ndaj dhe ka organizuar më shumë debate ku janë diskutuar dhe shqyrtuar çështje shumë të rëndësishme për shoqërinë kosovare. Kësisoj, janë organizuar madje sesione të veçanta për të debatuar rreth procesit të përmbushjes së Standardeve, reformës së pushtetit lokal, ekonomisë sigurisë dhe personave të pagjetur. Debatet ishin mirë të organizuara dhe ishin të hapura ndaj të gjithë atyre që dëshironin të flisnin. Së këndejmi, shumë miq të Kosovës me kënaqësi kanë konstatuar se Kuvendi është duke u shndërruar në një vend ku zhvillohen debate publike.

Tani ka ardhur koha për të avansuar punën, në mënyrë që jo vetëm të përgatiten më mirë përmbajtjet e debateve por edhe të sigurojmë që pas secilit debat të nxirren konkluzionet apo rekomandimet e duhura. Veç kësaj, komisionet mund të përgatisin edhe raporte mbi çështje të caktuara që miratohen në seanca plenare. Komisionet po ashtu mund të organizojnë edhe dëgjime publike mbi jetësimin e legjislacionit nga të cilat mund të dalin analiza të veçanta dhe sugjerime për të cilat ministritë duhet të japin përgjigje. Por, ministrat të cilët nuk marrin pjesë në sesionet e komisioneve dhe ato plenare mund të marrin vërejtje nga Kuvendi. Kështu është në të gjitha demokracitë parlamentare.

Ky edicion i Buletinit informativ të ASI-it përmban jo vetëm informata mbi ngjarjet e fundit në Kosovë dhe në institucionet demokratike të Kosovës por edhe mbi aktivitetet për mbështetje të Kuvendit. Kështu, pos tjerash, në këtë edicion mund të lexoni edhe për tryezën e rrumbullakët të Evropës Juglindore, e cila u mbajt për herë të parë në Kosovë, në fillim të muajit qershor. Ishte kjo një ngjarje jo vetëm me rëndësi historike, por edhe e rëndësishme për procesin e përmbushjes së Standardeve. Tani në kohën kur është duke u bërë vlerësimi gjithëpërfshirës i përmbushjes së Standardeve dhe kur z. Kai Aide është duke udhëtuar nëpër Kosovë, janë shtuar edhe shpresat dhe gjasat për gjetjen e një formule për fillimin e bisedimeve rreth statusit të ardhshëm. Njëherit, në këtë edicion kemi dhënë edhe një pasqyrë të zhvillimeve të fundit. Ndaj, shpresojmë se këto informacione do të jenë të dobishme dhe me interes për ju. S'do mend, sugjerimet tuaja janë gjithnjë të mirëseardhuara.

Franklin De Vrieze, Koordinator i ASI-it.

2. **Editorial / Debati për demokracinë**
Franklin De Vrieze
3. **Medllin Ollbrajt iu drejtua Kuvendit të Kosovës**
4. **Prishtina nikoqire e tryezës së rrumbullakët parlamentare të Evropës Juglindore**
Pitër Van Hojte dhe Franklin De Vrieze
6. **Zhvillimet më të reja në institucionet e Kosovës**
8. **Momente shumë të rëndësishme historike**
Skot Bejts
9. **Çështja e Kosovës u diskutua në AP¹ të NATO-s**
Doina Ghimici
12. **Mesi i vitit 2005: Koha për vlerësim**
Andriani Mortoglou
14. **Ministri kontraverz Serb**
Zoran Çulafiç
15. **Intervistë me kryetarin e komunës së Shtërpçës Stanko Jakovleviç "Komuna model, e cila është lënë pas dore nga institucionet qendrore"**
16. **Në hap me standardet**
Isuf Demaj
17. **Përkrahja Kuvendit të Kosovës**
19. **Regjistrimi i popullsisë në Kosovë**
Katja Salsbak



ASSEMBLY SUPPORT INITIATIVE
NEWSLETTER

Këshilli redaktues:

Sven Lindholm, Ramush Tahiri, Franklin De Vrieze, Blerim Vela, Labinot Hoxha, Edmond Efendija, Krenar Loshi

Selia e Misionit të OSBE, 10000 Prishtinë
Tel. (+381-38) 500 162 Fax: (+381-38) 500 188
kontakt kontakt: franklin.devrieze@osce.org
http: / /www.osce.org/ kosovo

Pikëpamjet e shprehura nga ata që kontribuan në këtë buletin, iu përkasin vetëm atyre dhe jodomosdoshmërisht paraqesin pikpamjet e Kuvendit, Misionit të OSBE-së në Kosovë apo të organizatave partnere të ASI-t.

Fotografitë e këtij buletini : Gazeta Express faqet 1, 3 (Ferdin Limani) / fq. 7, 14, 16, 17, 20 (Atdhe Mulla) / OSBE-ja fq. 4, 5, 8, 10, 15, 18 / UNMIK fq. 6 / NATO fq. 9 / Zyra për informim publik e ZKM fq. 12.

Medllin Ollbrajt iu drejtua Kuvendit të Kosovës

Ish-Sekretarja e Departamentit Amerikan të Shtetit Medllin Ollbrajt iu drejtua Kuvendit të Kosovës, në një seancë speciale plenare të mbajtur me 5 korrik në cilësinë e drejtueses së Institutit Nacional Demokratik për Marrëdhënie Ndërkombëtare (NDI). Gjatë vizitës së saj në Kosovë Znj. Ollbrajt u takua me liderë institucionalë, përfaqësues të opozitës, të shoqërisë civile dhe gra parlamantare. Në vijim po i japim disa fragmente nga fjalimi që mbajti në Kuvend

Gjatë këtyre gjashtë viteve të shkuara, ju i keni treguar botës së njerëzimit të Kosovës janë ndërtimtarë të vërtetë, jo vetëm ndërtimtarë të njohur në botë për ndërtimin e shtëpive dhe ndërtesave publike, por ndërtues të institucioneve të reja. Ju keni formuar parti politike dhe i keni mbajtur zgjedhjet. Ju keni zhvilluar mediat e pavarura dhe keni krijuar sistemin e drejtësisë. Ju keni bashkëpunuar në mënyrë konstruktive me bashkësinë ndërkombëtare. Dhe kështu i jeni afruar ditës së shumëpritur kur do të përcaktohet statusi final.

Meritat për këto të arritura u takojnë të gjithë njerëzve të Kosovës, shqiptarëve, serbëve, boshnjakëve, turqve, romëve, egjiptianëve, ashkalive, goranëve e të tjerëve, të cilët kanë dhënë kontributin e tyre për ndërtimin e një shoqërie më të mirë. Ndaj, keni shumë arsye për të qenë krenar. Njëherit, të arriturat e juaja i bëjnë krenardhemiqtë tuaj. Unë edikëtë, ngase unë jam një prej tyre, dhe do të jem gjithmonë. Ju po ashtu e dini se unë jam e sinqertë. Së këndejmi, ndiej përgjegjësi që t'ju bëj të ditur se çfarë mendoj për detyrat të cilat mbeten të papërbushura dhe njëherit t'ju paralajmëroj për sfidat përpara jush.

Së pari, ju përballeni me sfidën e krijimit të një ekonomie të shëndoshë e cila gjeneron vende pune, dhe që i bën njerëzit të besojnë se do të jenë në gjendje të ndërtojnë ardhmërinë e tyre në tokën e stërgjyshërve. Kosova e ka popullatën më të re, por gjithashtu edhe shkallën më të madhe të papunësisë në Evropë. Pyes veten, a thua vallë si qëndron puna me femrat. A do t'ju jepet atyre mundësi e barabartë për të



shkëlqyer në klasë, për të arritur suksese në vendet e punës, si dhe për t'i sëndërtuar ëndrrat e tyre në fushat në të cilat përcaktohen të punojnë—të bëhen biznesmene apo mjeke, gazetarë apo programere kompjuterësh, apo madje edhe kryetare apo kryeministre të ardhshme?

Sfida e dytë me të cilën ndeshet Kosova është ndërtimi i një shoqërie ku sundon rendi dhe ligji. Nuk është fshehtësi se korrupsioni dhe krimi paraqesin një problem këtu, ashtu si edhe në shumë vende të tjera të botës. Mirëpo, problemi nuk mund të adresohet përveç nëse haptazi e pranojmë dhe ballafaqohemi me te. Dhe ai nuk mund të zgjidhet përveç nëse policia dhe autoritetet gjyqësore janë të pavaruara dhe të paanshme, jashtë çdo dyshimi, dhe të përkushtuara që të hetojnë detajisht krimet pa marrë parasysh gradën apo pozitën e të akuzuarve, pa marrë parasysh nëse ata janë njerëz në pushtet apo opozitë.

Sundimi i ligjit arrihet kur publiku e kërkon atë me ngulm. Populli i Kosovës meriton jo më pak se kaq.

Sfida juaj e tretë është më themeloria. Ajo është që të ndërtoni një shoqëri të bashkuar, në të cilën secili grup etnik mund të marrë pjesë dhe kontribuojë. Kur isha këtu gjashtë vjet më parë kam thënë se ka njerëz të cilët dëshirojnë që Kosova të dështoj. Këta cinikë parashikonin se popullata shumicë në Kosovë do t'ua bëjë të pamundur jetën normale të tjerëve. Ata ishin të sigurt se Kosova e re do të jetë vend pa tolerancë dhe e dhunshme dhe se minoritetet do të ishin të diskriminuara, ndaj nuk do të ndjeheshin të mirëseardhura. Atëbotë unë pata parashikuar se ju do të provoni se këto pandehje janë të gabueshme.

S'do mend se puna e Kuvendit të Kosovës do të luajë rol vital si për arritjen e këtyre pikësnyimeve ashtu edhe për formësimin e ardhmërisë së Kosovës. Së këndejmi, ju, deputetë të Kuvendit,

do të luani rolin kryesor gjatë debateve, diskutimeve madje edhe gjatë polemikave plot pasion rreth veprimeve specifike dhe politikave, të cilat duhet t'i ndërmarrë qeveria juaj, në mënyrë që në fund të arrihet një kompromis. Kjo për faktin se kur punoni, këtë nuk e bëni thjesht për interesat tuaja personale apo partike; pra, ju punoni jo vetëm për ata që i përfaqësoni por edhe për interesat e Kosovës. Ndaj, kujtoj se deputetëve të Kuvendit u është dhënë besim shumë i madh.

S'ka pikë dyshimi se përgjegjësitë e koalicionit qeverisës janë të shumta. Por edhe ata që janë në opozitë kanë përgjegjësitë e tyre. Si anëtare e Partisë Demokratike të Shteteve të Bashkuara, më besoni se e di si është të jesh në opozitë. E urrej humbjen, por gjithashtu kam mësuar se kohërat ndryshojnë e me te ndryshojnë edhe mendimet dhe bindjet e votuesve. Në skenë dalin liderët e rinj. Dhe kështu, disa prej jush që sot jeni në opozitë, një ditë do të gjendeni në krye të qeverisë. Kjo është arsyeja pse opozita ka përgjegjësi jo vetëm të kritikoj, por edhe të paraqes idetë e veta. Kjo është njëherit edhe arsyeja pse të dy palët, si pozita ashtu edhe opozita kanë interes për t'i respektuar të drejtave e të tjerëve.

Në muajt e ardhshëm, komuniteti ndërkombëtar do të përcjellë nga afër progresin tuaj në ndërtimin e qeverisë në shërbim të qytetarëve, në përkushtimin tuaj për demokraci dhe në sukseset tuaja në krijimin e një Kosove të hapur dhe të sigurt për të gjithë. Afër mendsh, këto janë standarde të larta, ndaj mbikëqyrja me të cilin do të përballeni do të jetë vendimtare dhe jo aq e këndshme. Ardhmëria juaj varet nga ju, ashtu dhe duhet të jetë.



Prishtina nikoqire e tryezës së rrumbullakët parlamentare të Evropës Juglindore

“A mund të arrihet konsensus dorëheqjen e Minsitrit të Financave, meqë ai ka vendosur me vetëiniciativë ta ndryshojë buxhetin, pa i informuar kolegët e tij në qeveri dhe parlament? Ndaj si do ta mbrojmë Ministrin tonë deputetët e partive në pushtet? A do të kërkojë qeveria zgjedhje të parakohshme?” Fragment nga ca diskutime dhe negociata intensive dhe nganjëherë mjaft emocionale, të zhvilluara midis deputetëve nga Evropa Juglindore në Prishtinë prej 9 deri me 11 korrik 2005.

Pitër Van Hojte dhe Frenklin De Vrieze, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Kur kryetari i Kuvendit të Kosovës u uroi mirëserdhje mysafirëve në Hotelin Viktori në Prishtinë me 10 qershor 2005, nuk mund të mos vihej re sensi dhe rëndësia e tij historike. Përballë Prof. Nexhat Dacit ishin ulur 12 parlamentarë nga Evropa Juglindore. Për herë të parë delagacionet nga mbarë rajoni ishin mbledhur për të diskutuar çështje me interes të përbashkët, për t’u takuan me homologët e tyre nga Kosova dhe për t’u njohur me zhvillimet aktuale në Kosovë. Vlen të theksohet se kjo

ishte një ngjarje, në të cilën për herë të parë ishin mbledhur përfaqësuesit e të gjitha parlamenteve kombëtare dhe rajonale.

Tema qendrore e tryezës së rrumbullakët ishte marrëdhëniet midis parlamenteve dhe qeverive dhe organizimi i mbikëqyrjes efikase të ekzekutivit. Për Kosovën, por edhe për shumë parlamente të tjera të rajonit, kjo provon se ekziston nevoja jo vetëm për më tepër debate parlamentare mbi çështjet kryesore shoqërore, por edhe për seanca më të shpeshta plenare ku ministrat do t’i bënin

të qarta politikat e tyre, do të përgjigjeshin në pyetje dhe do të raportnin mbi zbatimin e ligjeve dhe rekomandimeve parlamentare.

Me këtë rast, Kuvendi i Kosovës përmes organizimit të kësaj tryeze të rrumbullakët tok me OSBE-në, ua ka bërë të qartë parlamenteve të vendeve fqinje se Kuvendi i Kosovës është partner i mirëfillët, se deputetët e këtij Kuvendi janë kolegë të deputetëve të parlamenteve të vendeve të tjera, ndaj dhe –si fqinjë– duhet të përfshihen

në ngjarje parlamentare rajonale. Deri tani nuk ishte kështu. Mirëpo, përmes përkrahjes së Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore u bë e mundur që të vihen themelet e një qasje krijtësisht tjetër: organizimi i ngjarjeve parlamentare rajonale ku përfshihen të gjitha parlamentet e zgjedhura të rajonit.

Gjatë punimeve të tryezës, u diskutua jo vetëm për mekanizmat formal dhe joformal por edhe për rolet e ndryshme të pozitës dhe të opozitës në raport me mbikëqyrjen e ekzekutivit.

Me këtë rast, parlamentarët u pajtuan se kontrolli efikas i qeverisë sidomos në fushat më të ndjeshme si buxheti dhe siguria është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Ndërsa, tani që janë duke u bërë përgatitjet për themelimin e Ministrisë së Rendit, një mbikëqyrje parlamentare efikase është parakusht themelor për krijimin e një policie, e cila do të ishte në shërbim të të gjithë qytetarëve. Një detyrë tjetër shumë me rëndësi për Kuv-

endin është edhe kontrolli efikas ndaj shpenzimeve të buxhetit. Ndaj dhe në Kuvendin e Kosovës do të organizohet një debat për shpenzimet e gjysëm vitit.

Dukej sheshit se për ta fuqizuar rolin e parlamenteve në mbarë rajonin ka nevojë për programe të veçanta për trajnime interaktive si dhe për shtimin e rrjetëzimit dhe bashkëpunimit me gjithë rajonin, si në nivelin multilateral ashtu edhe në nivelin bilateral. Vlen të vihet

në dukje se në këtë ngjarje po ashtu u ra dakord që Misioni i OSBE-së në Kosovë dhe Pakti i Stabilitetit për Evropën Juglindore të ndihojnë dhe lehtësojnë punën e grupeve punuese teknike rajonale në nivel të komisioneve. Kështu, OSBE-ja do të përqëndrohet në organizimin e mbikëqyrjes efikase në fushën e buxhetit dhe të sigurisë dhe njëherazi do të mbështesë zhvillimin e mëtejshëm të rrjetëzimit rajonal. Për këtë qëllim,

OSBE-ja do të krijojë një bazë të të dhënave të parlamenteve rajonale në internet (online), duke përfshirë këtu edhe informata specifike mbi parlamentet e rajonit, shërbimet e ndryshme, komisionet dhe deputetët.

Fare në fund, Përfaqësuesit e parlamenteve të rajonit ranë dakord që të organizojnë një konferencë tjetër në vitin 2006, e cila do të mbahej në njërin nga vendet e pjesëmarrësve të kësaj ngjarjeje.



Zhvillimet më të reja në institucionet e Kosovës



Kuvendi debaton mbi reformimin e pushtetit lokal

Më 19 maj Kuvendi i Kosovës ka diskutuar Programin e Punës për Reformimin e Pushtetit Lokal të miratuar nga qeveria me 24 shkurt. Me këtë rast, kryeministri Bajram Kosumi ka deklaruar se decentralizimi, i cili parasheh implementimin e pilot-projekteve, ofron zgjidhje për komunitetet pakicë dhe njëherit ndihmon në integrimin e këtyre komuniteteve përmes shpërbërjes së strukturave paralele. Kryeministri po ashtu vuri në dukje se programi i qeverisë do të shërbente edhe si bazë për diskutime gjatë negociatave për status. Lideri i PDK-së Hashim Thaçi kundërshtoi planin e qeverisë dhe deklaroi që implementimi i pilot-projekteve nuk është në frymën e Dokumentit Kornizë, të miratuar më parë nga qeveria. Ai po ashtu shprehu shqetësimin e tij se kjo do të çonte drejt ndarjes territoriale të Kosovës. Lideri i ORA-ës Veton Surroi konsideron se para implementimit të pilot projekteve është e domosdoshme që më parë të krijohet një kornizë e re kushtetuese dhe legjislative. Ai gjithashtu ka kritikuar planin për decentralizim, ngase ky plan nuk ka marrë parasysh implikimet buxhetore për krijimin e pilot njësive komunale. Ndërsa, qeveria u zotua se do ta informojë Kuvendin rregullisht mbi progresin e arritur si gjatë seancave plenare ashtu edhe përmes një Komisioni ad hoc për reformimin e pushtetit lokal, që pritet të themelohet së shpejti.

Fillimi i vlerësimit të përgjithshëm të standardeve

Më 27 maj, Sekretari Gjeneral i Kombeve të Bashkuara ka dhënë dritën e gjelbërt për fillimin e vlerësimit të përgjithshëm të standardeve. Kësisoj, me 4 korrik Sekretari Gjeneral i KB Kofi Anan ka emëruar diplomatën norvegjeze Kai Aide si të Dërguar Special për të bërë Vlerësimin e Përgjithshëm të Standardeve për Kosovën. Z. Aide me të arritur ka deklaruar që puna e tij nuk do të përqëndrohet vetëm në vlerësimin e plotësimit të standardeve por edhe në aspektet politike të situatës në Kosovë. Vlen të vihet në dukje se vlerësimi do të jetë i pavarur nga UNMIK. Ndërsa, z. Aide pritet të dorëzojë raportin e tij final gjatë muajit shtator 2005.

Filimi i punës së Forumit të Kosovës

Mbledhja inauguruese e Forumit të Kosovës, organit konsultativ, i cili përbëhet nga liderët e partive politike kryesore të shqiptarëve të Kosovës, u mbajt me 7 qershor. Në këtë mbledhje morrën pjesë PSSP-ja, Kryetari Rugova, Kryeministri Kosumi, lideri i partisë ORA Veton Surroi, Hajredin Kuqi nga PDK-ja dhe Kolë Berisha nga LDK-ja. Pas takimit, PSSP-ja bëri të ditur para mediave se pjesëmarrësit kanë rënë dakord se Forumi nuk do t'i zëvendësojë IPVQ-ët, por do të shërbejë si vend ku do të merren qëndrime të përbashkëta nga liderët shqiptarë të Kosovës lidhur me vlerësimin e përgjithshëm të Standardeve dhe procesin e përcaktimit të Statusit. Me 30 qershor u mbajt edhe mbledhja e dytë e Forumit të Kosovës. Në këtë mbledhje pjesëmarrësit e Forumit vendosën që të themelojnë Sekretariatën, i cili do të ndiqte më për së afërmi përgatitjet për procesin e Statusit. Njëherit, Forumi shprehu edhe mbështetjen e tij për vazhdimin e dialogut me Beogradin, si në nivelin teknik ashtu edhe ate politik.

Kryesuesi i OSBE-së diskuton për punën e Kuvendit me kryetarin e Kuvendit

Më 30 maj Ambasadori Verner Vnent, shef i Misionit të OSBE-së në Kosovë u takua me Kryetarin e Kuvendit të Kosovës Nexhat Daci. Me këtë rast, Ambasadori Vnent dhe Kryetari Daci pos tjerash diskutuan edhe për miratimin e Rregullorës së re të Punës. Ambasadori Vnent, nga ana e tij, rikonfirmoi përkushtimin e OSBE-së për të ofruar këshilla dhe për të ndihmuar si në ngritjen e kapaciteteve të Kuvendit ashtu edhe në lehtësimin e bashkëpunimit të Kuvendit me parlamente të tjera nga rajoni dhe Evropa. Kryetari Daci falenderoi Ambasadorin Vnent për mbështetjen e ofruar deri më tani nga OSBE-ja dhe ofertën për vazhduar me këtë mbështetje. Duke iu referuar rolit monitorues të Kuvendit, Kryetari Daci theksoi se nuk i pranon qortimet, por rekomandimet dhe sugjerimet e hapura dhe pozitive janë gjithnjë të mirëseardhura.

Kuvendi debaton për implementimin e standardeve

Në seancën plenare të 23 qershorit, Kryeministri Bajram Kosumi bëri një prezantim për implementimin e Standardeve, për të cilin u diskutua me orë të tëra. Me këtë rast, Kuvendi shprehu përkrahjen e tij për procesin e përmbushjes së Standardeve, mirëpo, vlerësimi i koalicionit qeverisës mbi progresin e arritur në përmbushjen e standardeve ishte shumë më i lartë se ai i opozitës, ngase ata vazhdimisht i referoheshin dhe theksonin korrupsionin në qeveri dhe shkeljen e procedurave në Kuvend. Ndërsa, në vazhdim të seancës plenare me 24 qershor Kuvendi miratoi, pas leximit të dytë, Projektligjin mbi Kërkesat Teknike për Produktet si dhe Projektligjin për Tokën Bujqësore. Veç kësaj, Kuvendi miratoi edhe shtatë ligje të tjera pas leximit të parë, përfshirë Projektligjin mbi Përdorimin e Gjuhëve, për të cilin ca deputetë reagues ndaj dispozitave, sipas të cilave gjuhës serbe i sigurohet një status më i avansuar krahasuar me gjuhët e tjera të minoriteteve në Kosovë.

Kryetari i Kuvendit kërkon që nënshkrimi dhe vënia në fuqi e ligjeve të mos vonohet

Me 5 korrik, Kryetari i Kuvendit Nexhat Daci kërkoj nga PSSP-ja Soren Jesen-Petersen që të mos vonohet me nënshkrimin dhe vënien në fuqi të ligjeve të miratuara nga Kuvendi. Këto komente Kryetari Daci i bëri pas takimit që pati me Jesen Petersenin. Takimi i tyre u përqëndruar në dinamikën të ligjeve nga ana e UNMIK-ut pas miratimit të tyre nga Kuvendi. Dihet se ligjet që miratohen në Kuvend nuk mund të vihen në zbatim pa pasur mbështetjen e Zyrës Ligjore të UNMIK-ut. Së këndejmi, disa ligje vonohen ose për arsye se nuk janë në pajtim me Kornizën Kushtetuese, ose për shkak se prekin në -fushat e rezervuara- të KB-ve, apo edhe për arsye se disa ankesa të deputetëve serbë të Kosovës ende nuk janë zgjidhur.

Kuvendi vazhdon të mbajë rregullisht dëgjime publike

Tanimë komisionet e Kuvendit e kanë bërë zakon, në kuadër të procesit legjislativ, që rregullisht të organizojnë dëgjime publike për të kërkuar jo vetëm opinion e ekspertëve por edhe sugjerime nga votuesit. Vetëm gjatë dy muajve të kaluar janë organizuar këto dëgjime publike.

Dëgjimi publik për Ligjin mbi Tokën Bujqësore, mbajtur me 9 maj 2005. Dëgjimi publik për Projektligjin mbi Arsimimin dhe Trajnimin e të Rriturve, mbajtur me 11 maj 2005. Dëgjimi publik për Projektligjin mbi Procedurën Administrative, mbajtur me 13 maj 2005. Dëgjimi publik për Projektligjin mbi Dhënien e Koncesioneve, mbajtur me 13 maj. Dëgjimi publik për Projektligjin mbi Liritë Fetare dhe Statusin Ligjor të Komuniteteve Fetare, mbajtur me 15 qershor. Dëgjimi publik për Projektligjin mbi Ngrahjen Qendrore, mbajtur me 27 qershor.



Delegacioni qeveritar viziton Vjenën dhe Brukselin

Një delegacion i Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë vizitoi Vjenën dhe Brukselin prej 26 deri me 30 qershor 2005. Gjatë takimeve të ndryshme, ministrat diskutuan për standardet prioritare, decentralizimin, të drejtat e minoriteteve dhe kthimin, dialogun me Beogradin, funksionimin demokratik të institucioneve, situatën e sigurisë dhe statusin final. Në Vjenë, delegacioni i IPVQ-ve zhvilloi takime si me kryesuesit aktual ashtu edhe ata të radhës të OSBE-së, Trojkën e UE-së, si dhe delegacionet e Rusisë dhe ShBA-ve pranë OSBE-së. Ndërsa, në Bruksel delegacioni u takua me Komisionerin për Zgjerim Oli Ren dhe me Përfaqësuesin e Lartë të UE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri të Përbashkët, Javier Sollana. Kjo vizitë ia bëri të mundur zyrtarëve të IPVQ-ve që t'i shkëmbejnë pikëpamjet e tyre lidhur me detyrat që e presin Kosovën në dritën

e konfirmimit të perspektivës evropiane të Kosovës, madje edhe në këtë situatë mjaft të vështirë edhe për vetë UE-në. Vizita u organizua nga OSBE-ja në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe Shtyllën e IV-të të UNMIK-ut. Një javë më parë, me 20 qershor 2005, një delegacion shumë partiak i Kuvendit të Kosovës nën udhëheqjen e kryetarit të Kuvendit Nexhat Daci, vizituan Parlamentin Evropian. Delegacioni i Kuvendit ishte ftuar nga znj. Doris Pack, udhëheqëse e delegacionit të EJL në Parlamentin Evropian. Ky është viti i tretë me radhë që Kuvendi i Kosovës është ftuar në Bruksel për konsultime dhe forcim të marrëdhënieve ndër-parlamentare.

Miratohet Ligji për Komisionin e Pavaruar të Mediave

Me 11 korrik 2005, Përfaqësuesi Special i KB-ve Soren Jesen-Petersen nënshkroi Ligjin për Komisionin e Pavaruar të Mediave. Me këtë rast, shefi i Misionit të OSBE-së, Ambasadori Verener Vnent deklaroi se "themelimi i Komisionit të Pavaruar të Mediave si organ rregullativ i mediave elektronike është një hap esencial në rrugën drejt krijimit të mediave elektronike të lira, të pavarura dhe profesionale". PSSP-ja ka nënshkruar Ligjin, të miratuar më parë nga Kuvendi, me një numër përmirësimesh, që bazohen në praktikat më të mira evropiane. Një përmirësim i rëndësishëm do të sigurojë se pavarësia dhe autoriteti i KPM-së është i ndarë nga autoriteti rregullues i Autoritetit Rregullues të Telekomunikacionit (ART). Ndërsa, ndryshimet tjera priten që të rrisin qartësinë e Ligjit dhe funksioneve të KPM-së. Komisioneri i Përkohshëm për Media, tani hyn në fazën e tranzicionit, pasi që do të zëvendësohet nga Komisioni i Pavaruar i Mediave. Komisioni do të jetë përgjegjës për licensim dhe rregullim të mediave elektronike në Kosovë. "Me këtë hap është siguruar e ardhmja e KPM-së në përmbushjen e përgjegjësi të veta," vuri në dukje Ambasadori Vnent, duke shtuar se "tashmë mund të fillohet me bartjen e autoritetit për rregullim të mediave tek institucioni vendor, që duhet të përfundojë deri në fund të vitit." Ndërsa, Bordi i Mediave për Ankesa do të vazhdojë të shqyrtojë rastet e ankesave të dorëzuara nga mediat e shkruara, derisa të themelohet një mekanizëm vetërregullues siç është Këshilli i Mediave të Shkruara.

Kahet e ardhshme të reformës së qeverisjes lokale në Kosovë në dritën e përvojës së Ballkanit

Përvojat e vendeve ballkanike në jetësimin e reformave për qeverisje lokale dhe inkurajimi i shkëmbimit të përvojave të fituara ishin në qendër të vëmendjes të konferencës ndërkombëtare me titull: "Reformat në Qeverisjen Lokale- Përvoja nga Evropa Juglindore", që u mbajt në Prishtinë me 6 dhe 7 qershor 2005. Kjo konferencë u organizua nga Misioni i OSBE-së në Kosovë, Ministria e Pushtetit Lokal, Asociacioni i Komunave të Kosovës, dhe Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP). Me këtë rast, vlen të vihet në dukje se punimet e konferencës u zhvilluan në tri panele, ku u diskutua për: 1) Institucionet dhe procedurat demokratike; 2) Komunitetet multi-etnike në qeverisjen lokale; dhe 3) Zhvillimin ekonomik në nivelin lokal. Mysafirët ndërkombëtarë, gjatë prezantimeve të tyre, shtjelluan aspekte të reformës së pushtetit lokal, çështje që kanë të bëjnë me transferimin e pronës tek komunitet, dhe na njoftuan me ndërlidhësit rajonal të qeverive të vendeve respektive. Pos kësaj, gjatë konferencës u prezantuan edhe përvojat e mira nga shumë komuna të Kosovës. Së shpejti do të nxirret edhe raporti mbi këtë konferencë, i cili do të jetë në dispozicionin tuaj.

Momente shumë të rëndësishme historike

Skot Bejts, Instituti Nacional Demokratik (NDI)



shumë me rëndësi, është fakti se qeveria vazhdoi së funksionuari. Kjo është dëshmi jo vetëm për urtinë dhe mençurinë e popullit të Kosovës, por edhe për autoritetin e institucioneve politike. Të dy këto zhvillime janë parakushte për të ecur përpara drejt hapjes së negociatave për statusin final dhe stabilitet afatgjatë. Ndonëse, Kosova është ende duke dhënë prova për plotësimin e "standardeve", megjithatë, provimin kryesor tanimë e ka kaluar qysh në pranverën e vitit 2005

Unë pata kënaqësinë që të takohem me mjaft të rinjë të zgjuar kosovarë, të cilët punojnë në Zyrrën e Kryeministrit, qeveri, Kuvend dhe OJQ si NDI-ja (IND). Ata tanimë kanë filluar të marrin poste udhëheqëse, ndaj kujtoj se e ardhmja e Kosovës do të jetë vërtetë e ndritshme, nëse këta shërbyes të përkushtuar do të vazhdojnë të mbeten të angazhuar në këtë proces. Njëherit, edhe vetëbesimi i tyre është shtuar jashtëzakonisht shumë gjatë këtyre viteve, prej se kam ardhur, dhe unë kujtoj se ky është një zhvillim shumë pozitiv.

Pos këtyre, unë kam vërejtur se edhe prezenca ndërkombëtare është reduktuar dukshëm, ndaj unë konsideroj se edhe ky është një zhvillim pozitiv afatgjatë. Megjithatë, për të bërë të mundur lëvizjen drejt krijimit të një demokracie në Evropë, duhet të ekzistojë një partneritet midis kosovarëve dhe ndërkombëtarëve. Njëherit, është shumë me rëndësi që Kosova të shndërrohet nga një vend që varet nga ndihmat ndërkombëtare në një anëtar të vetëqëndrueshëm të komunitetit Euroatlantik. Së këndejmi, unë gjithnjë kam besuar se suksesi i ndërkombëtarëve matet me atë se sa shpejt do ta kryejnë misionin e tyre dhe, duke mbajtur parasysh se si

qëndrojnë gjërat tani, mund të them se kjo tanimë është duke ndodhur.

Pas bisedave që kam zhvilluar me shumë miq të mi të partive dhe bindjeve të ndryshme, kuptova se ndërsa bashkësia ndërkombëtare ishte duke punuar rreth një qëndrimi të përbashkët për të ardhmen e Kosovës, populli i Kosovës ishte duke u përgatitur ngadalë dhe në mënyrë sistematike për ditën që së shpejti do të arrijë.

Kosovarëve, rruga drejt statusit final mund t'ju duket shumë e gjatë. Jam i sigurt se edhe mua do t'më dukej njësoj, sikur të ishte fjala për të ardhmen time. Megjithkëtë, sipas mendimit tim, duke mbajtur parasysh progresin që është arritur nga viti 2002 deri në vitin 2005, ka shumë arsye që të jemi optimist.

Është e vërtetë se ka gjithnjë sfida dhe se ngjarjet ditore nganjëherë shkaktojnë kriza dhe ndikojnë në situatën politike. Mirëpo, tek e mbarma, themelet e institucioneve demokratike të Kosovës janë të shëndosha. Qeveria funksionon, Kuvendi është duke ecur përpara me një ritëm, që ishte i paimagjinueshëm vetëm para gjashtë viteve.

Ka të ngjarë që gjatë këtij viti përfundimisht të vendoset paqja, stabiliteti dhe prosperiteti për të gjithë qytetarët e Kosovës, për t'u ndarë kështu nga historia tragjike jo e largët e Ballkanit. Së këtejmi, ma thotë mendja se miqtë e mi të vjetër, nga të gjitha nivelet politike dhe të qeverisjes në Kosovë, me vendosmëri do t'i tejkalojnë të gjitha betejat politike ditore. Mbetem me shpresë se ata vërtetë kanë vendosur të bëhen heronjë, dhe të bëjnë histori.

E ardhmja është në duart e Kosovës.

Egzistojnë një thënie sipas të cilës njeriut nuk i pëlqen të kthehet në shtëpi përsëri. Mirëpo, kur pas tri vjetësh u ktheva sërish për të punuar me Kuvendin e Kosovës, kuptova se kjo nuk ishte e vërtetë. Ishte kënaqësi të takoj dhe të punoj sërish me miqtë dhe kolegët e vjetër.

Kur u themelua Kuvendi i Kosovës aty nga fundi i vitit 2001, unë pata nderin dhe kënaqësinë e veçantë që të jem në shërbim të deputetëve në cilësinë e drejtorit të Institutit Nacional Demokratik në Prishtinë. Atëbotë, misioni ynë ishte shumë i qartë, të bëjmë gjithë që është e mundur për të fuqizuar Kuvendin, duke u ardhur në ndihmë jo vetëm deputetëve të Kuvendit por edhe të gjitha partive politike.

Kthimi im muajin e kaluar me ftesën e drejtorit të IND (NDI-së) z. Tom Bridëll ishte një shansë jetësore për mua. Meqë jam kthyer pikërisht në momentet kur Kosova është duke kaluar nëpër momentet vendimtare të historisë së saj.

Dorëzimi i kryeministrit të Kosovës z. Ramush Haradinaj, nuk u përcoll me dhunë, të cilën e kishin parashikuar shumë "ekspertë" të çështjeve të Ballkanit, por me protesta paqësore. Dhe ajo që është



Çështja e Kosovës u diskutua në AP¹ të NATO-s

Prej 16 deri me 18 qershor 2005, u mbajt seminari Rose-Roth i Asamblesë Parlamentare të NATO-s në Sveti Stefan të Malit të Zi. Ishte hera e parë që një seminar i tillë u organizua në bashkëpunim me Parlamentin e Republikës së Malit të Zi.

Doina Ghimici, Misioni i OSBE-së në Kosovë

¹Asambleenë Parlamentare

Tema e takimit ishte: "Serbia dhe Mali i Zi: Pajtimi i integritetit dhe ndarjes". Në këtë takim anëtarë, anëtarë të asociuar dhe vëzhgues të Asambleve Parlamentare të NATO-s u mbledhën për të diskutuar me ekspertë dhe përfaqësues ndërkombëtarë të organizatave qeveritare dhe joqeveritare. Me këtë rast, një numër i madh i diskutantëve nga rajoni, dhe përfaqësues të organizatave kryesore, shpалosën pikëpamjet e tyre si zyrtare ashtu edhe të pavaruara mbi situatën aktuale në Serbi dhe Mal të Zi, të ardhmen e Unionit, perspektivën e intergimitit Euro-Atlantik si dhe reformat në fushën e mbrojtjes. Ndërkaq, i gjithë debati i ditës së fundit u përqëndrua rreth Kosovës.

Në sesionin e mëngjesit që u moderua nga Peter Roman, përfaqësues i Club de Madrid dhe ish-kryeministër i Rumunisë, në dy panele të ndryshme u diskutua rreth marrëdhënieve ndëretnike në Kosovë dhe rolit të bashkësisë ndërkombëtare. Ndërsa, sesioni i pasdites me titull: Kosova: drejt statusit final dhe u moderua nga William Montgomeri, ish-ambasador i SHBA-ve në Serbi dhe Mal të Zi. Vlen të vihet në dukje se nisur nga përvoja që është krijuar, që më tepër se një vit, Misioni i OSBE-së në Kosovë i ka ardhur në ndihmë Sekretariatit të AP të NATO-s rreth përgatitjes së sesioneve për Kosovën, duke lehtësuar kështu pjesëmarrjen e dy deputetëve të Kuvendit, Veton Surroit and Enver Hoxhaj, të cilët e morrën fjalën në panelin e fundit. Qeveria e Kosovës përfaqësohej nga Lutfi Haziri, Ministër i Pushtetit Lokal, ndërsa shoqëria civile nga Albin Kurti, drejtues i KAN-it. Në panel që të dy diskutuan mbi marrëdhëniet ndëretnike me Milorad






Todoroviçin, deputet i Kuvendit të Unionit Sërbi-Mali i Zi dhe ish-deputet i Kuvendit të Kosovës dhe Nenad Xhurxheviçin nga Projekti i Prinstonit për Marrëdhënie Etnike. Veç kësaj, Françesko Bastagli, Zv.PSSP/ Kryesues i Shtyllës së II-të, Fernando Xhentilini, Përfaqësues Personal i Përfaqësuesit të Lartë të UE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri të Përbashkët dhe Zolt Rabai nga Selia e NATO-s i informuan parlamentarët e NATO-s mbi rolin e tashëm dhe të ardhshëm të bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë. Qëndrimi zyrtar i Beogradit përkitazi me statusin e ardhshëm/final, u prezantua nga Damjan Mishkoviçi, këshilltar për politikë të jashtme i Presidentit Tadiç dhe Aleksandar Simiçi, këshilltar për çështje ligjore i Kryeministrit Koshtunica, ndërsa Dushan Janjiç, nga Forumi për Marrëdhënie Etnike, shfaqti pikëpamjet e tij mjaft të pavaruara shikuar nga aspekti legal.

Ky seminar ishte një rast ideal për akterët e ndryshëm që t'i bëjnë të njohura qëndrimet e tyre dhe njëherit t'i identifikojnë elementet dhe pikëpamjet për të cilat pajtohen por edhe ato për të cilat pajtohen kur është fjala si për të ardhmen e Kosovës dhe për modalitetet për definimin e statusit të ardhshëm të Kosovës. Për fat të keq, të vetmet gjëra për të cilat ranë dakord shqiptarët dhe sërëbët e Kosovës ishin vendimi i bashkësisë ndërkombëtare se viti 2005 është koha kur duhet të vlerësohet progresi i arritur dhe të bëhet progres drejt zgjidhjes së statusit, dhe se decentralizimi substancial, si në nivelin administrativ ashtu edhe politik, është e vetmja mënyrë për të siguruar një ambient të qetë dhe të sigurt për serbët, në kohën kur Kosova pritet të fitojë një status të ri. Ndonëse, tek të dy palët ekzistojnë ndryshime në mënyrën e perceptimit dhe të interpretimit, pritet e tyre megjithatë janë mjaft të

ngjashme. Mirëpo, ekzistojnë dallime të madha midis të dy palëve sa i takon jo vetëm status kuosë por edhe mënyrës se si duhet të ecet përpara. Është me rëndësi të vihet në dukje se në këtë seminar për herë të parë Beogradi zyrtar i ka bërë të ditura ca detaje lidhur me propozimin e tyre tanimë të njohur, por megjithatë ende të paqartë për "më tepër se autonomi, më pak se pavarësi." Ata nuk ofruan kurrfarë alternative ndaj kërkesës së shqiptarëve për pavarësi, por në vend të kësaj ata flisnin për gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë në mënyrë konstruktive në bisedime rreth statusit, kurdo që të fillojnë ato, dhe të pranojnë një zgjidhje të pazakonshme, ndonëse ata do të papapëlqenin një zgjidhje që do të shpiente kah "një autonomi e zgjeruar me garancione ndërkombëtare."

Është e qartë se një zgjidhje realiste duhet të vijë nga bashkësia ndërkombëtare. Mirëpo, në një kohë kur Evropa është duke u përballur me krizën kushtetuese, parlamentarët e NATO-s, ndonëse dëshirojnë të ritheksojnë zotimin e tyre ndaj Ballkanit Përendimor, ata megjithatë janë ndërduzash për atë se a do të jetë në gjendje bashkësia ndërkombëtare të ridefinojë angazhimin e saj në Kosovë dhe në të njetën kohë të garantojë një zgjidhje e cila do të pajtonte procesin e pandalshëm të pavarësimit me zotimet e mëherëshme të bashkësisë ndërkombëtare, për të garantuar siguri të lartë për sërëbët e Kosovës, për të bërë të mundur përmirësimin e situatës jashtëzakonisht të rëndë ekonomike dhe sociale dhe për të siguruar që lidhshipi politik kosovar të jetë më kompetent dhe më i përgjegjshëm.



Presidenti: **Ibrahim RUGOVA**Ministri
i Pushtetit
Lokal:**Lutfi
HAZIRI**Ministri
i Financave dhe
Ekonomisë:**Haki
SHATRI**Ministri
i Arsimit, Shkencës dhe
Teknologjisë:**Agim
VELIU**Ministri
i Rinisë, Kulturës
dhe Sporteve:**Astrit
HARAÇIA**Ministri
i Transportit dhe
Komunikacionit:**Qemajl
AHMETI**Ministria
e Shërbimeve
Publike:**Melihat
TËRMKOLU**Zëvendës Ministri
i Pushtetit
Lokal:**Aziz
LILA**Zëvendës Ministri
i Financave dhe
Ekonomisë:**Muharrem
IBRAHIMI**Zëvendës Ministri
i Arsimit, Shkencës dhe
Teknologjisë:**Fevzi
BERISHA**Zëvendës Ministre
e Rinisë, Kulturës dhe
Sporteve:**Angjelina
KRASNIQI**Zëvendës Ministri
i Transportit dhe
Komunikacionit:**Hafiz
KRASNIQI**Zëvendës Ministri
i Shërbimeve
Publike:**Mark Zejneli
KOMANCI**

Lidhja Demokratike e Kosovës – LDK

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës – AAK


Partia Shqiptare Demokristiane e
Kosovës – PSHDK

Partia Demokratike e Kosovës – PDK

Lista Qytetare – ÖRA

Partia Demokratike Serbe e Kosovës dhe
Metohisë (SDS-KiM)


Partitë Minoritare

**Fatmir
SEJDIU****Naim
MALOKU****Xhavit
HALITI**

QEVERIA E KOSOVËS



Kryeministri: **Bajram KOSUMI**



Zëvendës Kryeministri: **Adem SALIHAIJ**

Ministri
i Tregtisë dhe
Industriës:



**Bujar
DUGOLLI**

Ministri
i Energjetikës dhe
Minierave:




**Et'hem
ÇEKU**

Ministri
i Punës dhe
Mirëqenies Social:



**Ibrahim
SELMANAJ**

Ministri
i Mjedisit dhe
Planifikimit Hapësinor:




**Ardian
GJINI**

Ministri
i
Shëndetësisë:




**Sadik
IDRIZ**

Ministri
i Bujqësisë, Pylltarisë
dhe Zhvillimit Rural:



Ministri
për Kthime dhe
Komunitete:



**Slaviša
PETKOVIĆ**

Zëvendës Ministri
i Tregtisë dhe
Industriës:




**Kadri
KRYEZIU**

Zëvendës Ministri
i Energjetikës dhe
Minierave:



**Agron
DIDA**

Zëvendës Ministri
i Punës dhe
Mirëqenies Social:




**Lulzim
LECI**

Zëvendës Ministri i
Mjedisit dhe Planifikimit
Hapësinor:



**Merxhan
AVDYLI**

Zëvendës
Ministri i
Shëndetësisë:



**Astrit
AJETI**

Zëvendës Ministri i
Bujqësisë, Pylltarisë dhe
Zhvillimit Rural:



**Tomë
HAJDARAJ**

Zëvendës Ministri
për Kthime dhe
Komunitete:



**Ibush
BAJRAMI**

KRYESIA E KUVENDIT



Kryetari i Kuvendit: **Nexhat DACI**




**Ramë
BUJA**



**Gazmend
MUHAXHERI**



**Džezair
MURAT**



Mesi i vitit 2005: Koha për vlerësim

Andriai Mortoglu, Misioni i OSBE-së në Kosovë

Tanimë ka ardhur koha për vlerësimin, që ishte papashikuar për mesin e këtij viti. Qysh në nëntor të vitit 2003, Mark Grosman, nënsekretari i shtetit për Çështje Politike të SHBA-ve, pati paralajmëruar se progresi në përbushjen e standardeve për Kosovën do të mund të vlerësohej në mesin e vitit 2005, me mundësinë që në rast të vlerësimit pozitiv të fillohet edhe me bisedimet rreth statusit. Ky paralajmërim pati inicuar një proces, i cili është menduar që të arrijë kulminacionin gjatë kësaj vere. Ashtu si është parashikuar, më 4 qershor 2005 Sekretari i Përgjithshëm i KB emëroi Ambasadorin norvegjez Kai Aide si "Të dërguar special për vlerësimin e përgjithshëm të Kosovës". Aide dhe ekipi i tij tashmë kanë zhvilluar vizitën e tyre të parë në Prishtinë dhe në Beograd dhe janë në prag të vizitës së dytë me radhë.

Sipas mandatit të paraparë të Dërguarit, vlerësimi i përgjithshëm është pjesë e "e vazhdimësisë së përgjegjësive së Kombeve të Bashkuara ndaj Kosovës sipas Rezolutës 1244, e cili parashesh edhe përgatitjen e një procesi politik për përcaktimin e statusit të ardhshëm të Kosovës. Ndaj, ky vlerësimi do t'i shërbejë si bazë Sekretarit Gjeneral për të vlerë-

suar se a janë pjekur kushtet për të inicuar një proces të definimit të statusit të ardhshëm."

Përkundër lidhjes së ngushtë që ka me procesin e Standardeve, vlerësimi nuk do të kufizohet vetëm në Standardet për Kosovës, ndaj sigurisht se nuk do të jetë vetëm një rivlerësim i rëndomtë i standardeve prioritare. Në vend të përqendrimit në aspektin "teknik" të standardeve, vlerësimi mëton të analizojë situatën e përgjithshme politike në Kosovë, duke marrë parasysh njëherit edhe trendet dhe perspektivat e ardhshme për një progres të vazhdueshëm dhe të qëndrueshëm në implementimin e Standardeve. Pritet që çështjet kyçe që do të shqyrtohen të përfshijnë edhe performancën demokratike të autoriteteve komuale dhe qendrore, lëvizjen e lirë të qytetarëve të të gjitha komuniteteve, kthimin e sigurtë të personave nëpër shtëpitë e tyre, zbatimin e të drejtës mbi pronën, dhe përparimin në procesin e reformimit të pushtetit lokal. Që nga vizita e tij e parë, Aide ka inkurajuar IPVQ-të që të arrijnë progres konkret në reformimin e pushtetit lokal, duke sinjalizuar kështu që procesi i decentralizimit do të zë vend qëndror në vlerësimin e tij.

Një mesazh me rëndësi që bash-

kësia ndërkombtare dëshiron t'ia përcjellë IPVQ-ve dhe qytetarëve të Kosovës është që vlerësimi i përgjithshëm nuk është një përfundim i ditur. Aide është i autorizuar që të bëjë një vlerësim objektiv, të pavarur nga UNMIK-u dhe bazuar vetëm në studimet e veta, ndaj ai gjatë vlerësimit nuk mund të ndikohet assesi nga ndonjë përfundim paraprakisht të përcaktuar. Pikërisht për këtë arsye edhe ai udhëton së bashku me ekipin e tij nëpër Kosovë për të biseduar me njerëz të ndryshëm që përfaqësojnë interese të ndryshme për të patur një pasqyrë gjithëpërfshirëse të realiteteve komplekse kosovare. I Dërguari do të vizitojë edhe vendet e rajonit dhe kryeqtetet e vendeve të Kontakt Grupit. Ai më pas do t'i raportojë Sekretarit Gjeneral të Kombeve të Bashkuara- diku nga shtatori- dhe në bazë të studimeve dhe rekomandimeve të tij, të vendoset nëse bisedat mbi statusin do të fillojnë dhe në rast se ato fillojnë cilat do të mund të ishin modalitetet që duhet pasuar gjatë atij procesi.

Standardet para, gjatë dhe pas statusit

Udhëheqësit e IPVQ kanë arsye për të qenë optimist që Vlerësimi do të rezultojë në rekomandimin për fillimin e bisedi-

meve rreth statusit, ndonëse rezultati nuk është i paracaktuar. Një optimizëm i tillë rrjedh nga dy burime: e para që përpjekjet e fundit për implementimin e standardeve ka lënë përshtypje të mira tek Bashkësia Ndërkombtare. Takimi i Këshillit të Sigurimit mbi Kosovën mbajtur më 27 Maj ka sinjalizuar një mirënjohje të përgjithshme për progresin e arritur në Kosovë në përbushjen e standardeve- pa u ndaluar në dallimet e vogla të pozicioneve të shprehura nga anëtarë të Këshillit të Sigurimit mbi mjaftueshmërinë e suksesit në implementimin e standardeve- por që unanimisht kanë pranuar një Vlerësim të Përgjithshëm. Dhe së dyti, duket të ketë një ndërrim në disa qendra, sidomos në SHBA, shprehur nga nën sekretari i shtetit për çështje politike Nikolas Bérns i cili pohoi gjatë fjalimit të tij të mbajtur më 18 maj në Kongres që – në drejtim të Standardeve dhe Statusit duhet uluar të priturat në arritjet e bëra në mënyrë që të ecet përpara me inicimin e bisedimeve rreth statusit.

Në fjalimin e tij pranë Këshillit të Sigurimit më 27 maj, I Dërguari Special Sorenjesen Petersen deklaroi që nuk është në interes vetëm të Prishtinës zgjedhja e statusit të Kosovës, por është edhe në interes të Beogradit dhe të tërë rajonit, meqë një gjë e tillë kontribuon në stabilitetin e përgjithshëm. Ai gjithashtu sugjeroi që me zgjedhjen e statusit "do të marrë fund edhe pasiguria, dhe do të jemi dëshmitarë të rezultateve konkrete në çështjet si ato të kthimit, lirisë së lëvizjes dhe ekonomi. Zgjedhja e statusit do të rezultojë edhe në përfitime të qarta rajonale përfshirë këtu dialogun rajonal dhe tregtinë...Lënia e kësaj çështjeje pezull do të vonojë procesin e integrimi rajonale dhe ç'rast do të ndikonte negativisht në intereset e përgjithshme..."





Sido që të jetë, ky mesazh nuk mund të kuptohet si inkurajim për vetkënaqësi për IPVQ për të pritur të behen progrese të mëtutjeshme në fushat në shënjestër për standardet. Statusi nuk mund të shihet si ilaq për të gjitha problemet që ka Kosova. Progresi në implementimin e standardeve është çelësi i çuarjes përpara të proceseve politike në Kosovë, dhe atë jo pse ato përbëjnë pjesën integrale të politikës 'Standardet para Statusit' por pse ato luajnë rol thelbësor në inkurajimin e multietnicitetit, dialogut, vlerave demokratike, pa të cilat asnjë zgjedhje e statusit nuk do të arrihej dhe as që do të zinte vend në Kosovë. Meqë progresi në zbatimin e standardeve gjatë dhe pas bisedimeve ofrojnë bazën për qëndrueshmërinë e zgjedhjes politike, as vlerësimi dhe as fillimi i bisedimeve për statusin –kurdo herë që të fillojnë– nuk do të nënkuptojnë fundin e implementimit të Standardeve.

Kështu që, implementimi i standardeve duhet të vazhdojë. Kjo është thënë edhe nga Kryeministri Bajram Kosumi në fjalimin e tij gjatë debatit mbi standardet në Kuvendin e Kosovës më 23 qershor, duke e ndërlidhur kështu bisedën me perspektivën e Kosovës në integrimet europiane. Ndërkaq, Kuvendi i Kosovës u përgjigj duke njohur progresin e arritur deri tani por edhe duke kërkuar standarde, progrese dhe impenjime shtesë nga qeveria. S'do mend se roli i Kuvendit të Kosovës nuk është vetëm të ushtrrojë kontroll mbi të arriturat e qeverisë, por edhe të asistojë, mbështesë, udhëzojë dhe implementojë edhe vet Standardet. Në këtë mënyrë, Kuvendi mbanë përgjegjësinë e vet, duke siguruar që standardet të mbesin prioriteti kryesor në agjendën e Kosovës.

Ministri kontraverz Serb

Pas intervistës me Oliver Ivanoviçin në edicionin e shtatëmbëdhjetë të Buletinit informativ të ASI-it, në këtë edicion kemi përfshirë një shkrim për portretin e Sllavisha Petkoviçit, Ministrin për Komunitete dhe Kthim.

Zoran Çullafiç, gazetar i pavarur nga Beogradi

Sllavisha Petkoviçi është emëruar Ministër për Komunitete dhe Kthim në kabinetin e ish kryeministrit Ramush Hajredinaj me 26 janar 2005. Mirëpo, që nga ajo kohë, politikanët serb si në Kosovë ashtu edhe në Beograd, vazhdimisht kanë refuzuar që ta njohin atë si figurë relevante politike. Për më tepër, Petkoviçi është duke u injoruar pothuajse nga të gjithë zyrtarët e lartë serb. Ata këtë e arsyetojnë me faktin se ai ka marrë vetëm 269 vota në zgjedhjet e vitit 2004 për t'u bërë pastaj një përfaqësues ekskluziv i serbëve të Kosovës. Në të vërtetë, Petkoviçi nga këto qarqe shihet si figurë e parëndësishme politike, i cili i shërben vetëm intereseve të tij, dhe që ua bërë të mundur shqiptarëve të Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare që të pandehin se Kosova është shoqëri multietnike. Së këndejmi, gjer më tani nuk ka ndonjë informatë apo indikacion se ndonjë nga politikët e nivelit të lartë nga Beogradi e ka kontaktuar apo se ka ndërmend ta kontaktojë Petkoviçin në një të ardhme të afërt, për të lehtësuar dhe përshpejtuar procesin e kthimit të personave të zhvendosur brenda vendit, çështje kjo për të cilën Beogradi konsideron se është kryesore për komunitetin serb në Kosovë.

Me 25 qershor të vitit 2005 z. Petkoviçi themeloi Partinë Demokratike Serbe të Kosovës dhe Metohisë (SDS-KiM), që është trashigimtare politike e Iniciativës Qytetare të Sërbisë, përmes së cilës pastaj e fitoi postin aktual.

Petkoviçi ka lindur në Ferizaj në vitin 1966, ai ka kryer shkollën e mesme dhe nuk ka pasur përvojë politike para vitit 2004. Partia Demokratike e Hashim Thaqit ka votuar kundër emërimit të tij në Kuvend, duke e akuzuar atë se ka



qenë pjestarë i një njësie paramilitare gjatë konfliktit të vitit 1998-99 në Kosovë. Kështu, e përditshmja beogradase "Kurir" pohon se ka prova se Petkoviçi ka qenë pjesëtar i dalluar i njësisë sekrete speciale famëkeqe të policisë serbe (JSO), e cila është shpërbërë vetëm pas vrasjes së ish-kryeministrit Zoran Xhinxiç, ndërsa disa nga epurorët e lartë të kësaj njësie janë ende duke u gjykuar për një mori vrasjesh dhe krimesh serioze. Madje, Petkoviçi edhe vetë e ka konfirmuar publikisht, një muaj pas emërimit të tij në emisionin UNMIK On-Air, se ka marrë pjesë "në tri lufta si oficer i policisë", por këtë pohim nuk e ka elaboruar më tepër.

Megjithatë, daklaratat e para të tij publike (para zgjedhjeve të tetorit 2004) u vlerësuan lartë si nga bashkësia ndërkombëtare ashtu edhe nga shqiptarët e Kosovës, ngase përdorej një gjuhë e re dhe inkurajuese, e cila rrallëherë është dëgjuar në të kaluarën nga pala serbe. Duke e konsideruar këtë fakt si një bazë të mirë për iniciimin e një qasjeje të re ndaj Kosovës, disa zyrtarë të lartë ndërkombëtarë kanë insistuar me ngulm që Beogradi mos ta injorojë, por të bisedojë me të vetmin serb në qeverinë e Kosovës si për kthimin e serbëve ashtu edhe për çështje të tjera politike.

"Jemi ne dhe jo dikush nga Beogradi ata që po jetojnë këtu; ndaj dhe ne duhet ta marrim vetë fatin në duart tona. Ne që jetojmë në Kosovë dhe Metohi nuk duhet të lejojmë më që politika e Beogradit të vendosë për ardhmërinë tonë. Së këndejmi, nuk duhet të lejojmë as që partitë nga Beogradi të urdhërojnë përzgjedhjen e kuadrit të tyre partiak si përfaqësues tonë për Kosovë dhe Metohi." Kjo ishte njëra nga deklaratat e para të Ministrit Petkoviçi, i cili pohon se ai mund t'ia dalë mbanë që ta zgjedhë çështjen e serbëve të Kosovës me liderët e shqiptarëve të Kosovës dhe se nuk ka nevojë për ndërhyrjen e Beogradit.

Derisa nga njëra anë është herët të thuhet nëse Petkoviçi do t'i shkojë doresh që të bëjë ndonjë ndryshim të konsiderueshëm në skenën politike jashtëzakonisht të polarizuar, nga ana tjetër është e qartë se tanimë ai mund të shërbejë si një lloj nxitësi për përshpejtimin e inkuadrimin të një grupi tjetër politik dhe parlamentar serb, që drejtohet nga Oliver Ivanoviçi, në institucionet e Kosovës. Për këtë arsye, Petkoviçi është kërcënuar publikisht se do të orvatet t'ia marrë të tetë vendet e rezervuara për Listën Serbe për Kosovë dhe Metohi të Ivanoviçit, nëse ky i fundit vazhdon të refuzojë marrjen e tetë mandateve në Kuvend.

Në të njëjtën kohë, ajo që është shumë me rëndësi është se Petkoviçi shihet nga disa analistë dhe qarqe të caktuara politike si një pikë kthese e cila do të mund të mbështetë nga ca sinjale që po vijnë nga politika e re e Beogradit, politikë kjo që tevona është duke u artikulluar sheshazi përmes Dushan Batakoviçit, këshilltarit për çështje të Kosovës të Presidentit të Sërbisë Boris Tadiç.

Kështu, Batakoviçi ka përkrahur fuqimisht qëndrimin se duhet t'i jipet fund bojkotit politik, i cili ka filluar që nga shpërthimi i dhunës në mars të vitit 2004 në Kosovë, së këndejmi mund të thuhet se dalja në pah e një politike të re të Beogradit është konfirmuar zyrtarisht edhe nga deklaratat publike e Batakoviçit.

"Në Kosovë, me përjashtim të pak rasteve, në 15 vitet e fundit nuk është ndjekur një politikë aktive, e përgatitur mirë dhe e peshuar si duhet nga aspekti strategjik. Mirëpo, tani janë pjekur kushtet dhe ka ardhur koha që të zhvillohet një politikë më dinamike përmes iniciativave të reja, reale dhe të qëndrueshme," vuri në dukje Batakoviçi.

Ndonëse, Beogradi publikisht mbase askurrë s'do ta pranojë rolin pozitiv të Ministrit Petkoviçi, dalja e tij në skenën politike, megjithatë, mund të konsiderohet si një lëvizje pozitive, që mund të kundrohët edhe në kontekstin e ndryshimeve evidente në gjuhën politike të Sërbisë lidhur me çështjet që kanë të bëjnë me Kosovën.

Edhe pse, kjo lëvizje pozitive duhet jo vetëm të shpërblehet por edhe fuqimisht të përkrahët, megjithatë mbeten ende e paqartë nëse komuniteti politik serb në Kosovë do të t'ia dalë mbanë që të përgatisë një platformë të përbashkët për të përfituar nga këto lëvizje pozitive apo mbase do të kridhet edhe më tepër në krizën e tij politike, krizë kjo që po kërcënon që ata të mbeten në marginat e ngjarjeve, në vitet më vendimtare për të Kosovën e kohërave moderne. Së këndejmi, faktorët kryesorë ndërkombëtarë duhet të kenë një qasje më të ndjeshme dhe më konstruktive për të ndihmuar në krijimin e marrëdhënieve më të mira dhe më produktive serbo-shqiptare.

Intervistë me kryetarin e komunës së Shtërpcës Stanko Jakovleviç

“Komuna model, e cila është lënë pas dore nga institucionet qendrore”

Z. kryetar, a mund të na thoni diçka për bashkëpunimin dhe bashkëveprimin midis komunës së Shtërpcës dhe qeverisë së Kosovës?

Fatkeqësisht, nuk ka shumë gjëra pozitive që mund të thuhet përkitazi me bashkëveprimin. Pse? Pikësepari, zyrtarët nga Shtërpca dhe posaçërisht kryetari i komunës së Shtërpcës nuk ftohen në Prishtinë për konsulta dhe diskutime. Kështu që, na kanë lënë anash. Ndaj, s'mund të mos e kritikoj këtë dukuri. Ngase, meqë jemi model i komunës shumëetnike, neve duhet të na bëhet e mundur që jo vetëm t'i shfaqim pikëpamjet tona, por edhe ta japim kontributin tonë për zhvillimet. Çështje tjetër është mosrespektimi i përdorimit të gjuhëve zyrtare nga qeveria e Kosovës. Domethënë, të gjitha dokumentet që i pranojmë nga qeveria qendrore dërgohet vetëm në gjuhën shqipe. Ne jemi të vendosur t'i furnizojmë shërbyesit tanë civil dhe këshillëtarët komunal me tërë dokumentacionin në gjuhën serbe dhe atë shqipe. Pranimi i dokumenteve nga IPVQ-të vetëm në gjuhën shqipe e shton në mënyrë të konsiderueshme barrën e përkthyesve tanë dhe e ngadalëson zbatimin e përgjithshëm të punëve.

Cilat janë marrëdhëniet aktuale të komunës së Shtërpcës me komunat fqinje?

Komuna e Shtërpcës kufizohet me katër komuna të tjera: Ferizajin, Kaçanikun, Suharekën dhe Prizrenin. Me Ferizajin dhe kryetarin e kësaj komune kemi bërë përçapje të caktuara për vendosjen e bashkëpunimit, posaçërisht për çështjet e kthimit, pasi që kemi numër të madh të personave të zhvendosur nga Ferizaji të cilët janë të vendosur në Shtërpce që nga viti 1999.

Me komunën e Kaçanikut nuk ka shumë kontakte. Përfaqësuesi i vetëm institucional nga kjo komunë me të cilin jam takuar zyrtarisht është komandanti i stacionit policor. Ai më ka siguruar se në territorin të cilin e mbulon SHPK-ja e Kaçanikut siguria për serbët e Kosovës të cilët udhëtojnë në drejtim të Shkupit është e garantuar. Unë besoj se kjo do të realizohet.

Sa i takon komunave të Suharekës dhe Prizrenit, deri më tash nuk kemi pasur kontakte me to. Vlen të vihet në pah se Shtërpca ka strehuar një numër të madh të personave të zhvendosur nga Prizreni, por nuk ka pasur sinjale të mirëfillëta nga kjo komunë për të bashkëpunuar me Shtërpçen rreth kthimit të serbëve të Kosovës. Ndaj, mbetet të shihet nëse do të fillojnë bisedimet, posaçërisht me komunën e Prizrenit.

Çka do të përmendnit si praktikën më të mirë të komunës së Shtërpcës që do të mund të shfrytëzohej nga komunat e tjera?

Shtërpca është komunë me institucione të mirëfillta shumëetnike, ku minoriteti i shqiptarëve të Kosovës i ushtron të gjitha drejtat: ka përfaqësim të shqiptarëve të Kosovës në vetëqeverisjen lokale, Shërbimin policor të Kosovës, gjykatën komunale, etj. Ata janë integruar në shoqëri, dhe kjo do të duhej ta paraqiste një shembull të praktikës së mirë. Unë do t'u rekomandoja të gjitha komunave në tërë Kosovën që ta bëjnë të njëjtën gjë që ka bërë Shtërpca. Unë jam i sigurtë se, sa i përket bashkëjetesës pakicë-shumicë, serbët e Kosovës në komunat e tjera nuk do të kërkonin më shumë se sa kemi arritur ne në territorin tonë.

Njëherit, ne mund të merremi si shembull edhe sa i takon lirisë së lëvizjes. Sezoni i skijimit këtë dimër e ka dëshmuar këtë, që po e them, më së miri, ngase dihet se nuk kemi pasur asnjë incident gjatë këtij sezoni, ndonëse kishte shumë turistë shqiptarë të Kosovës.

Kur është fjala për nevojat e komunës së Shtërpcës, cilat mendoni se janë prioritetet e kësaj komune?

Unë së pari do të thoja ca fjalë për ekonominë. Shtërpce është komunë me rëndësi, ngase kjo komunë ka edhe një specifikë tjetër: para luftës një numër i konsiderueshëm i

banorëve të saj kanë qenë të punësuar në komunat përreth. Ndërsa, tani të gjithë ata banorë janë të papunë dhe pa ndonjë asistencë të mirëfilltë dhe institucionale. Askush nuk kujdeset për ta. Për këta njerëz nuk ia kanë dalë mbanë, që të sigurojnë asistencë sociale as programet sociale, që janë implementuar në kompanitë e privatizuara, por as AKM-ja apo bashkësia ndërkombëtare. Vetëm Republika e Serbisë ndan ca mjete të vogla për ta. Së këtëjmi, mbijetesa e tyre në këto troje është vënë në dyshim dhe është vetëm çështje kohe dhe mundësie kur këta banorë do ta lëshojnë Shtërpçen për të shkuar në Serbinë qendrore. Ne dëshirojmë t'i ringjallim të gjitha kompanitë në Shtërpce, të cilat tani janë në zonën gri, që nuk kanë prodhuar asgjë për vite me radhë.

Si do ta përshkruanit bashkëpunimin tuaj të gjertanishëm me Zyrën e OSBE-së në Shtërpce, në përgjithësi dhe me Misionin e OSBE-së në Kosovë, në përgjithësi?

Unë kam një bashkëpunim shumë të mirë me OSBE-në si organizatë, dhe po ashtu kam kontakte dhe bashkëpunim të afërt me Zyrën e OSBE-së në Shtërpce. Kësisoj, unë konsultohem me kolegët e OSBE-së sa herë që kam ndonjë shqetësim lidhur me vetëqeverisjen. Ndaj, i jam mirënjohës në mënyrë të veçantë Zyrës së OSBE-së në Shtërpce për të gjitha përpjekjet që ka bërë për t'na ndihmuar rreth themelimit të komisioneve. Po kështu, ata janë ende duke na ndihmuar në krijimin e rrjetit të fshatit për përfshirjen e strukturave rurale me qëllim që të përmirësohet komunikimi me qytetarë.

*Intervistën e zhvilloi
Milosava Banasheviç*



Në hap me standardet

Isuf Demaj, Sekretari i Kuvendit të Kosovës

Gjatë viteve të fundit, Administrata e Kuvendit të Kosovës në punën e saj ka arritur progres të konsiderueshëm. Kjo kryesisht është rrjedhojë e angazhimeve dhe aktiviteteve vetanake në ngritjen dhe konsolidimin e kapaciteteve të Kuvendit. Deri më sot, nëpërmjet 'Projektit për Mbështetjen e Kuvendit' të Agjencisë Evropiane për Rindërtim, Kuvendi ka qenë i mbështetur në procesin e ndërtimit të kapaciteteve. Kjo mbështetje, para se gjithash është manifestuar në zgjerimin e strukturës organizative të Kuvendit me racionalizimin e kompetencave dhe përgjegjësi në Kuvend, Administratë dhe Kryesi.

Gjithashtu, përmirësime të theksuara si rrjedhojë e përkrahjes ka pasur në implementimin uniform të rregullave të procedurave dhe përsosjen e rregullave të stafit. Si rezultat i trajnimit të stafit administrativ janë rritur shërbimet që administrata e Kuvendit i ofron në mbështetje të seancave plenare dhe mbledhjeve të komisioneve me theks të veçantë në përpunimin dhe harmonizimin e legjislacionit me parametrat e duhur. Së fundi, është dhënë mbështetja për zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve me institucionet e tjera të përkohshme të vetqeverisjes (IPVQ), si dhe masave për rritjen e ndërveprimit në mes të Kuvendit dhe shoqërisë civile.

Në kuadër të projektit 'Përkrahje arkivit elektronik parlamentar në Kosovë' - SPEAK administrata e Kuvendit ka përfunduar mbështetjen për krijimin e të dhënave zyrtare dhe gazetës zyrtare. Projekti ka realizuar qëllimet e veta nëpërmjet krijimit të sistemit të regjistrimit



dhe arkivimit elektronik të të dhënave për Administratën e Kuvendit dhe Plenarin.

Zhvillimi institucional

Në prizmin e zhvillimit të seksionit të përkrahjes ligjore dhe procedurale për komisionet parlamentare, mbështetja ligjore dhe procedurale është një nga aktivitetet kryesore që administrata e Kuvendit ofron për komisionet parlamentare, kryesinë, seancat plenare dhe grupet parlamentare. Në mandatin e kaluar kapaciteti i stafit për mbështetje komisioneve ka qenë nën nivelin e përmbushjes së kërkesave të deputetëve dhe të komisioneve. Për këtë qëllim, Kuvendi në bashkëveprim me partnerët e Iniciativës për Përkrahje Kuvendit - ASI, ka ndërmarrë veprime konkrete për ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve që përkrahin punën e të gjitha organeve të Kuvendit.

Aftësimi i stafit përmes trajnimeve të organizuara nga partnerët, ASI dhe 'Projektit për Mbështetjen e Kuvendit', ka ndikuar në ngritjen e kualitetit të shërbimeve të stafit në ofrimin e këshillave juridike

dhe procedurale, si dhe ofrimin e ekspertizës profesionale për deputet dhe për komisione parlamentare.

Sfidat dhe prioritetet

Sfida e vazhdueshme me të cilën administrata e Kuvendit ballafaqohet është sëndërtimi sa më i drejtë i parimeve bazë të punës. Këto parime përfshijnë respektimin e parimit të ligshmërisë, parimi i paanshmërisë gjatë punës, parimi i përfaqësimit të drejtë të shërbimit civil, në veçanti në monitorimin dhe zbatimin e procedurave me qëllim të zbatimit të politikës jodiskriminuese të personelit në kuadër të administratës dhe parimi i profesionalitetit në punën e administratës së Kuvendit. Përmeshja e parimeve të sipërcikura bën të mundur përmbushjen e prioritetëve të shërbimeve të administratës si menaxhimi më efikas dhe transparent.

Sfidë tjetër paraqet edhe buxheti i Kuvendit të Kosovës i cili për vitin 2005 ishte rreth 7 milion euro, shumë kjo e ndarë për deputetët e Kuvendit, administratën e Kuvendit dhe Kryetarin e Kuvendit. Deri në

Në administratën e Kuvendit janë të punësuar gjithsej 139 punëtorë prej të cilëve 60 me përgatitje superiore, 6 me përgatitje të lartë dhe 73 me përgatitje të mesme shkollore. Struktura etnike është si vijon: 119 shqiptarë, 10 serb, 7 turq dhe 3 nga komunitetet tjera. Ndërsa, për sa i referohet strukturës gjinore 79 janë meshkuj dhe 60 femra.

korrik 2005, nga kjo shumë janë shfrytëzuar rreth 42 për qind të mjeteve financiare. Për vitin e ardhshëm parashihet që buxhet për Kuvendin të jetë 40 për qind më i lartë se ai i vitit 2005, duke arritur shumën rreth 10 milion euro.

Sfidë e rëndësishme për administratën e Kuvendit është mirëmbajtja e ndërtesës së Kuvendit me ç'rast shpesh ka hasur në vështirësi të konsiderueshme. Kjo kryesisht si rrjedhojë e faktit që ndërtesa është e tejngarkuar pasi që në të janë të akomoduar edhe stafi i Zyres së Kryetarit të Kosovës, stafi i Kryeministrit të dhe ai i Ministrisë së Transportit dhe Post-telekomunikacionit.

Në frymën e profesionalizimit dhe bashkëpunimit me Kryesinë e Kuvendit, grupet parlamentare dhe Ministrinë e Shërbimeve Publike, administrata ka arritur rezultate të kënaqshme. Synohet që në të ardhmen, administrata të ofrojë një katalogë më të gjerë të shërbimeve që do të jenë të cilësisë dhe sasisë së duhur. Këto janë standardet të cilat administrata e Kuvendit është duke punuar dhe synon ti përmbush.

Përkrahja Kuvendit të Kosovës

Rritja e cilësisë dhe konsistencës shumëgjuhësore të draft legjislacionit

Ky projekt gjatë dy muajve të fundit ka vazhduar punën rreth përkrahjes ligjore dhe gjuhësore të komisioneve, fuqizimit të kapaciteteve institucionale dhe mirëmbajtjes së faqes së internetit të Kuvendit të Kosovës. Ndërsa, Njësia Ligjore për Standardizim/Shqyrtim ka vazhduar me mbështetjen e gjashtë komisioneve. Kështu, kjo njësi ka mbështetur punën e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale për finalizimin e amendamentimit të draftligjit mbi Sigurinë Shëndetsore. Pos kësaj, në kuadër të ngritjes së kapaciteteve institucionale, është përgatitur një raport mbi përparësitë e harmonizimit të legjislacionit me standardet europiane të Rregullores së Punës. Njëherit, me kërkesën e Kuvendit, eksperti ligjor ka hartuar draftligjin mbi Kushtet për Punësim të Personelit të Kuvendit si dhe draftligjin mbi organizimin dhe funksionimin e Kuvendit. Veç kësaj, është mirëmbajtur dhe azhurnuar rregullisht faqja e internetit të Kuvendit të Kosovës. Në këtë kuadër është bërë jo vetëm ndërrimi i formatit të seksioneve të veçanta në faqen e internetit, por edhe riaranzhimi i faqes dhe përkthimi i materialeve. Projekti është financuar nga OSBE-ja dhe është zbatuar nga Instituti Ndërkombëtarë i Mbrojtjes së Parisit.

Fillon votimi përmes sistemit elektronik në Kuvend

Gjatë seancës së 24 qershorit 2005, Kuvendi i Kosovës ka filluar të përdorë sistemin elektronik të votimit. Kështu, amendamente të shumta të draftligjeve në shqyrtim janë votuar në mënyrë elektronike pa ndonjë problem. Pas kontrollit të sistemit dy javë më parë, duke se sistemi funksionon dhe stafi teknik është trajnuar dhe motivuar si duhet që të fillojë ta përdorë këtë sistem. Njëherit, edhe drejtuesit e komisioneve janë informuar mbi statusin e sistemit. Së këndejmi, pas një takimi me shefin e Misionit të OSBE-së, Kryetari i Kuvendit të Kosovës vendosi që të fillojë me përdorimin e sistemit menjëherë. Ndërsa, një përfaqësues i OSBE-së ka shoqëruar stafin teknik gjatë përgatitjes së votimeve dhe seancave, për të monitoruar kështu përdorimin e sistemit. Së shpejti do të publikohet një raport i detajzuar me rekomandime mbi funksionimin dhe avansimin e sistemit.



SPEAK t'i dorëzohet Kuvendit në gusht të vitit 2005

Projekti 'Mbështetja e Arkivës Elektronike Parlamentare të Kuvendit' (SPEAK) është në fazën e vet përfundimtare, që sipas parashikimeve duhet të përfundojë në gusht të vitit 2005. Një sistem elektronik për menaxhimin e dokumenteve (SEMD) do t'i dorëzohet Kuvendit së bashku me liçencën e përhershme, mbështetje teknike deri në tetor të vitit 2006, softuerë profesional për skanim dhe njohje optike të simboleve (OCR dhe ICR) si dhe pajisje të tjera të nevojshme teknike. Projekti është realizuar në sja të mbështetjes financiare të AER-it, qeverisë norvegeje, UNDP-së dhe Unionit Ndërparlamentar. Njëherit, Kuvendi i Kosovës në Bibliotekën Kombëtare dhe Universitare të Kosovës ka themeluar edhe një Qendër Informative për Qeverisje Parlamentare, e cila do të bëjë të mundur thëllimin e bashkëpunimit të qytetarëve dhe anëtarëve të Kuvendit. Kështu që, në këtë qendër çdo qytetarë i interesuar për qeverisjen parlamentare mund të gjej informacione të mjaftueshme jo vetëm mbi jetën parlamentare në Kosovë, por edhe informata mbi parlamente të tjera. Gjatë kësaj periudhe Qendra ka promovuar diskutime të ndryshme për temat dhe problemet aktuale dhe mbizotëuese të jetës parlamentare, me një pjesëmarrje të kënaqshme të deputetëve të Kuvendit dhe qytetarëve. (Informacion nga Ali Caka, UNDP/IPU)

Komisioni për Arsim është mbështetur në hartimin e strategjisë për arsim

Gjatë javës së dytë të qershorit 2005, z. Reijo Aholinen, ekspert për arsim nga Finlanda ka filluar punën rreth mbështetjes së Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Rini, Kulturë dhe Sporte të Kuvendit të Kosovës. Vlen të theksohet se eksperti për arsim është angazhuar nga OSBE-ja me kërkesën e Komisionit. Ai do të asistojë në hartimin e një strategjie të arsimit dhe të planit të punës për të fuqizuar rolin e komisionit parlamentar në fushën e arsimit. Gjatë katër muajve të ardhshëm eksperti do t'i japë këshilla Komisionit lidhur me disa draftligje mbi arsimin, do ta mbikëqyrë implementimin e legjislacionit të miratuar për arsim dhe njëherit do të përgatisë një strategji shumëvjeçare mbi arsimin. Projekti do të përfundojë me një konferencë që do të mbahet në fund të shtatorit 2005 me ç'rast Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Rini, Kulturë dhe Sport do të prezentojë strategjinë shumëvjeçare për arsimin dhe planin veprues.

Takimi për ngritjen e kapaciteteve të praktikantëve të grupeve parlamentare

Më 1 dhe 2 qershor, OSBE-ja ka organizuar një takim për praktikantë të grupeve parlamentare të LDK-së, PDK-së, AAK-së, ORA-ës dhe grupit parlamentar 6+ , në kuadër të

Programit për Praktikantë në Kuvendin e Kosovës. Qëllimi i këtij takimit ishte përgatitja e praktikantëve për përbushjen e përgjegjësiave organizative dhe administrative, që u delegohen nga kryesuesit e grupeve parlamentare, si dhe trajnimi i tyre për zhvillimin e shkathhtësisë së shkrimit praktik, hulumtimit dhe organizimit, të cilët do t'u ndihmojnë gjatë tërë punës praktike. Dita e parë e takimit u përqëndrua në vetëdijsimin e praktikantëve për rolin e grupeve parlamentare në dritën e miratimit të rregullorës së re të punës të Kuvendit të Kosovës dhe procesit legjislativ. Ndërkaq, gjatë ditës së dytë puna është përqëndruar në zhvillimin e shkathhtësisë të shkruarit, menaxhimit të zyrës dhe aftësi hulumtuese, shkathhtësi këto që do t'ju nevojiten gjatë punës së tyre. Nëse ka nevojë dhe nëse kërkohet nga grupet parlamentare, OSBE-ja mund të organizojë asistencë plotësuese për praktikantët.

Ribotohet Fjalori i shprehjeve parlamentare dhe ligjore

Misioni i OSBE-së në Kosovë ka ribotuar Fjalorin e shprehjeve parlamentare dhe ligjore. 1000 kopjet e para janë shpërndarë nëpër të gjitha zyret ligjore dhe njësitë për përkthim të IPVQ-ve. Mirëpo, për shkak të interesimit të shtuar të ekspertëve dhe institucioneve vendore, OSBE-ja ka botuar edhe 500 kopje shtesë të këtij Fjalori. Ndaj dhe institucionet dhe ekspertët që dëshirojnë të marrin një kopje mund ta kontaktojnë Misionin e OSBE-së në Kosovë përmes adresës <labinot.hoxha@osce.org>

Botimi i Rregullorës së Punës së Kuvendit

Misioni i OSBE-së në Kosovë në bashkëpunim me Friedrich-Ebert-Stiftung ka përfunduar punën rreth publikimit të Rregullës së Punës të Kuvendit në katër gjuhë, anglisht, shqip, serbisht dhe turqisht. Ky botim përmban Rregulloren e re të Punës së Kuvendit të Kosovës si dhe ekstraktet relevante nga Rregullorja e Punës së Qeverisë dhe Korniza Kushtetuese për Kuvendin e Kosovës.

Iniciativa për Mbështetjen e Kuvendit (ASI) – planet për 2005/2006

Organizatave kryesore anëtare të ASI-it gjatë takimit dyditor të mbajtur më 28-29 maj kanë diskutuar mbi problemet kryesore rreth funksionimit të Kuvendit, progresin e arritur dhe pengesat në jetësimin e projektit, si dhe për vendosjen e prioritetëve dhe perspektivat për një bashkëpunim më të ngushtë në kuadër të ASI-it. Në këtë ngjarje morrën pjesë përfaqësues nga OSBE-ja, NDI-ja, UNDP/IPU-ja, Konzortiumi i AER-it dhe Zyra amerikane. Me këtë rast, organizatat e ASI-it kanë diskutuar në mënyrë të veçantë për mbështetjen e ardhshme Sekretariatit të Kuvendit, seancave plenare, kryesisë së Kuvendit, grupeve parlamentare dhe komisioneve parlamentare. Njëherit, janë shqyrtuar edhe çështjet kryesore të politikave të ardhshme, që ndërlihen dhe që kanë të bëjnë me Kuvendin, siç janë transferi i kompetencave, procesi i decentralizimit, fuqizimi i mekanizmave të brendshëm të llogaridhënies në IPVQ-të dhe përgatitjet për procesin e dialogut.

Po kështu, është diskutuar edhe angazhimi i pamjaftueshëm politik i minoriteteve gjatë punës parlamentare.

OSBE përgatit mbështetjen për Komisionin për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve

Në fillim të korrikut, OSBE-ja ka mbajtur një takim me kryesuesin dhe zëvendës-kryesuesit e Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve në Kuvendin e Kosovës. Qëllimi i këtij takimi ishte identifikimi i problemeve në punën e komisionit dhe i mënyrave përmes së cilave Misioni i OSBE-së do të mund ta ndihmonte këtë Komision për t'i përbushur përgjegjësitë në mbikëqyrjen e proceseve ekzekutive dhe legjislative, që kanë të bëjnë me të drejtat dhe interesat e komuniteteve. Kryesuesi dhe nënkryesuesit kanë raportuar që përkundër dallimeve evidente midis anëtarëve, mungesa e kapaciteteve ligjore dhe dështimi i IPVQ-ve që t'u përgjigjen iniciativave të tyre ka rënduar punën e komisionit për ç'arsye komisioni edhe nuk ka ia ka dalur që t'i përfaqësojë interesat e komuniteteve si duhet. Së këndejmi, OSBE-ja po shqyrton mundësitë dhe mekanizmat për të mbështetur kapacitetet ligjore të komisionit dhe rolin e tij në mbikëqyrjen e ekzekutivit.



Regjistrimi i popullsisë në Kosovë

Qëllimi i regjistrimit të popullsisë është mbledhja dhe përpunimi i të dhënave demografike, sociale dhe ekonomike; ndaj, mund të kundrohet si një lloj pasqyre e të gjithë banorëve që jetojnë në një territor të caktuar në një kohë të caktuar.

Katja Salsbak, Misioni i OSBE-së në Kosovë

IPVQ-ët me përkrahjen e UNMIK-ut kanë filluar përgatitjet për regjistrimin e popullsisë dhe amvisërive, i cili ka për qëllim grumbullimin e të dhënave mbi madhësinë, strukturën dhe shpërndarjen gjeografike të popullatës së Kosovës. Së këndejmi, në mungesë të të dhënave të azhmuara mbi popullsinë, institucionet e Kosovës, gjatë hartimit të politikave, kanë qenë shpeshherë të shtrënguara që të mbështeten në supozime. Ndaj dhe azhurmimi i të dhënave, që janë të vjetra 25 vjet, përmes regjistrimit në Kosovë do të bëjë të mundur përmirësimin e kësaj gjendjeje dhe njëherit do ta hapte edhe rrugën për krijimin e politikave të shëndosha në sfera nga më të ndryshmet, përfshirë këtu reduktimin e varfërisë, rritjen ekonomike, përmirësimin e shëndetit dhe arsimin.

Regjistrimi është planifikuar të mbahet në prill të vitit 2006, por, për shkak të përgatitjeve të mëdha që duhet të bëhen, ende nuk është marrë vendimi përfundimtar për kohën kur duhet të mbahet. Ndonëse, detajet rreth kësaj ndërmarrjeje politikisht të ndjeshme ngelin akoma të padefinuara, është më se e qartë se si qeveria, ashtu edhe OJQ-të dhe bashkësia ndërkombëtare kanë nevojë për të dhëna të besueshme për popullatën e Kosovës. Për më shumë, dihet se Kombet e Bashkuara rekomandojnë që regjistrimi i popullsisë të bëhet çdo dhjetë vjet. Në Kosovë regjistrimi i fundit është mbajtur në vitin 1981, ndërsa pas një viti kur pritet të mbahet regjistrimi tjetër bëhen 25 vite nga regjistrimi i vitit 81. Zyra e Statistikave e ish RSFJ-së kishte organizuar një regjistrim të popullsisë në vitin 1991, mirëpo rezultatet nuk janë komplete, ngase

shumica e shqiptarëve nuk morrën pjesë në të.

Sipas Ligjit mbi vendbanimin dhe regjistrimin e popullsisë në Kosovë, të miratuar në Kuvend më 11 korrik 2003, dhe të nënshkruar nga i Dërguari Special i KB-ve më 13 dhjetor 2004, Komisioni Qendror për Rregjistrim ka për detyrë që të mbikëqyrë dhe koordinojë regjistrimin e planifikuar. Së këtejmi, Kuvendi i Kosovës më 23 mars 2005 mbështeti Komisionin dhe angazhoi Melihate Termkollin që ta kryesojë atë. Funkzioni kryesor i Komisionit është që të mbikëqyrë punën e Entit Statistikor të Kosovës, i cili është agjencion ekzekutiv i Ministrisë së Shërbimeve Publike, dhe i cili ka për detyrë kryerjen e regjistrimit.

Vlen të vihet në dukje se numërimi i të gjithë banorëve dhe vendbanimeve në një territor, pastaj i banorëve përkohësisht jashtë vendit, është një ndërmarrje jashtëzakonisht e vështirë logjistike. Për më tepër, në Kosovë, qeveria dhe UNMIK-u duhet të përballen edhe me çështje mjaft komplekse politike, si fjala vjen, cilët grupe të banorëve të përfshihen në mesin e atyre grupeve që gjenden jashtë Kosovës për një periudhë të gjatë, si p.sh PZHV në Serbi dhe Mal të Zi, refugjatët dhe Diaspora. Sipas rregullorjes nr. 2004/53 për Regjistrimin e Popullatës në Kosovë definimi i "popullatës vendase" për qëllime të regjistrimit duhet të bëhet në koordinim me Përfaqësuesin Special. Sipas standardeve ndërkombëtare në regjistrim të popullatës nuk mund të përfshihen personat që kanë qëndruar jashtë vendit më shumë se 12 muaj. Megjithatë, mund të bëhen përjashtime, pra marrëveshje dhe numërime të veçanta, por vetëm nëse



procesi i regjistrimit të popullsisë nuk devijon nga standardet e parashikuara, ngase atëhere vihet në rrezik njohja ndërkombëtare e rezultateve.

Çështja e përfshirjes është e lidhur me definimin dhe qëllimin e vet regjistrimit. Regjistrimi i popullsisë nuk është as regjistrim civil dhe zakonisht as nuk lidhet me nënshpëtimin. Por, më tepër është një proces i grumbullimit dhe përpunimit të të dhënave demografike, sociale dhe ekonomike për planifikim zhvillimor; pra, mund të themi se është një pasqyre e të gjithë banorëve, që banojnë në një territor të caktuar në një kohë të caktuar.

Ligji për regjistrim obligon banorët e Kosovës që t'u përgjigjen pyetjeve të regjistrimit, që kanë të bëjnë me moshën, vendbanimin, arsimin, profesionin, gjuhën dhe përkatësinë etnike- ndërsa, pyetja e fundit është opcionale. S'ka pikë dyshimi se Ligji garanton mbrojtjen e plotë të informatave personale të të anketuarve dhe këto të dhënat përdoren vetëm për qëllime statistikore.

Llogaritet se shpenzimet për regjistrim do të jenë diku rreth 7 deri

8 milion euro, shumica e të cilave pritet të jetë kontribut i donatorëve, ndërsa për sigurimin e mjeteve do të kontribuojë edhe Buxheti i Konsoliduar i Kosovës. Ndaj, do të duhet të organizohet një konferencë donatorësh për të grumbulluar fonde për këtë qëllim. Buxheti për regjistrim do të mbulojë gjithë procesin, që nga krijimi i hartave të besueshme, trajnimi i stafit dhe mobilizimi i opinionit publik deri te numërimi dhe analiza dhe publikimi i të dhënave. Me këtë rast, në kuadër të këtij projekti do të punësohen me mijëra njerëz në Kosovë për të bërë numërimin e popullatës.

Është ende herët të thuhet nëse çështjet e pazgjidhura praktike dhe politike do të mund të zgjidhen me kohë, në mënyrë që regjistrimi i popullatës së Kosovës të mbahet ashtu si është planifikuar, në prill të vitit 2006 apo mbase edhe do të shtyhet. Pavarësisht nga kjo, një gjë është e qartë, regjistrim i sukseshëm në Kosovë do të kontribuonte shumë në krijimin e politikave të bazuara nga autoritetet vendase.



Kalendari i takimeve

Data / Vendi / Organizatori / Titulli / Pjesëmarrësit / Çështjet

11-13 Shtator (dtk) /

Cetinje/Mali i Zi /

Parlamenti i Malit të Zi & Parlamenti i Serbisë dhe Malit të Zi /

Forumi i 7të Parlamentar i Cetinjes – Takim i Komisioneve të Financave dhe Buxhetit /

Kryetarët dhe anëtarët e Komisioneve të Financave dhe Buxhetit /
- Procesi i përgatitjes së buxhetit në Parlament – Procedurat e Auditimit të përgjithshëm dhe raportimit në Parlament – Buxhetimi në Parlament /

18-23 Shtator /

Vienë /Austri /

Fondi Monetar Ndërkombëtar & Insitituti i Përbashkët i Vienës /

Seminar mbi politikat makroekonomike për parlamentarët nga Bosna dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia dhe Serbia dhe Mali i Zi /

Parlamentarët e përfshirë në përcaktimin e çështjeve financiare dhe ekonomike /
- Roli dhe funksioni i FMN – Programet kombëtare financiare – Zhvillimet e fundit ekonomike dhe perspektiva për regionin e Ballkanit – Transparenca fiskale dhe reforma e taksave – Sistemi financiar dhe reforma e sistemit bankar – Politika monetare dhe kursit të këmbimit – Qeverisje-Luftimi i financimit të terrorizmit dhe largjes së parave – Promovimi i investimeve dhe rëndësia e reformave strukturale /

6-8 Tetor /

Milocer/Mali i Zi /

Asambleja Parlamentare e OSBE-së /

Takimi Vjetor /

Delegacionet e Parlamenteve të EJL në Asambenë Parlamentare të OSBE-së /

17/18 Tetor (dtk) /

Shkup/Maqedoni /

Asambleja Parlamentare e Këshilit të Evropës /Komisioni për Migrimi,

Refugjatë dhe Popullim /

Takim pune për Migrimi dhe Refugjatë /

Deputetë nga EJL dhe PACE (duke përfshirë edhe Kaukazin Jugor) të përfshirë në çështjet e azilit dhe migrimit

- Personat e zhvendosur dhe të zhdukur, refugjatët /

3-6 Nëntor /

Dubrovnik/Kroaci /

Fondacioni Friedrich Ebert /

Konferenca parlamentare: Modeli evropian ekonomik dhe social.

Kontributi i parlamenteve për drejtësi sociale dhe zhvillim ekonomik /

Deputetët e përfshirë në çështjet ekonomike dhe sociale të UE-së /

- Modeli evropian ekonomik dhe social – Politika ekonomike dhe e punësimit – Politika sociale dhe fiskale – Politikën për në Evropë sociale /

7-10 Nëntor (dtk) /

Beograd/Serbi /

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës/Komisioni për Kulturë,

Shkencë dhe Arsim /

Takim pune i fokusuar në Arsimim dhe Qytetari 2005– kampanjë /

Përfshirja e parlamentarëve në aktivitetet që do të: - Forconin shoqëritë demokratike duke përkrahur një kulturë të gjallë demokratike – Krijojnë një ndjenjë të përkatësisë dhe zotimit për një shoqëri demokratike – Risë ndërgjegjen për vlerat e përbashkëta /

15/16 Nëntor /

Prag/Republika Çeke /

Pakti i Stabilitetit për EJL /

Takim Rajonale dhe takimi i grupeve punuese /

Parlamentarë nga EJL /

27-29 Nëntor (dtk) /

Cetinje/Mali i Zi /

Parlamenti i Malit të Zi & Parlamenti i Serbisë dhe Malit të Zi /

Forumi i 8të Parlamentar i Cetinjes – Takim i Komisioneve për Legjislacion/

Kryetarët dhe anëtarët e Komisioneve për Legjislacion /

- Procedurat legjislative – Rregullat e punës së Parlamenteve /

8-9 Dhjetor /

Selanik/Greqi /

Fondacioni i Mbretit Baudouin & Komisioni Evropian /

Seminar për Parlamentarët nga EJL për trafikimin e qenjeve njerëzore,

migrimit ilegal, azilit dhe çështjeve lidhur me vizat /

3 deputetë nga secili parlament i përfshirë në këto çështje /

- Zhvillimet e fundit në acquis,masat e marra nga UE në fushën e azilit dhe migrimit /



MARRË NGA:
STABILITY PACT
FORGOTTEN BUT NOT FORGIVEN